



Data: 08.08.2017

Ref.: 65517

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.566/17, datë 20.07.2017 e BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.550/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.550/17, datë 06.07.2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca me 20.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 550/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegjit të Shkencave Mjekësore Rezonanca nuk i është akredituar programi i studimit: Mjekësi e Përgjithshme, Dr. Med. 360 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca, është konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë asnjë argument i cili do të mund të merrej në konsideratë nga KSHC. Vendimi i KSHC-së për mos akreditim të programit të studimit është bazuar në Direktivën Evropiane për programin në Mjekësi të Përgjithshme, sipas së cilës puna praktike dhe teorike duhet të ofrohet nga një universitet, apo nën mbikëqyrjen e një universiteti.

Andaj, bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

